



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 23.12.2019, ora 13.30

Drejton mbledhjen

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. Miratimi i listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve të lejuar për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019 dhe rishpallur për plotësimin e kandidaturave në datën 09.09.2019.

2. Miratimi i raportit për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019 dhe rishpallur për plotësimin e kandidaturave në datën 09.09.2019

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|---------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Fatjona Memçaj | (anëtare) |
| 4. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 5. Eriol Roshi | (anëtar) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit
2. Enio Haxhimihali, përfaqësues i Avokatit të Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës
2. Mimoza Arbi, përfaqësuese e Kryetarit të Kuvendit

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se anëtarja e Këshillit, zonja Arta Marku e cila, për motive personale, nga njoftimet që kam pasur nuk ka qenë në detyrë këto ditë. Gjithsesi është kuorum për zhvillimin e mbledhjes, jemi 5 anëtarë në këtë mbledhje të sotme.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Miratimi i listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve të lejuar për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019 dhe rishpallur për plotësimin e kandidaturave në datën 09.09.2019.

Miratimi i raportit për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019 dhe rishpallur për plotësimin e kandidaturave në datën 09.09.2019

Sugjerohet që në lidhje me procesverbalet të mos diskutohet në fillim por në fund të mbledhjes.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Erinda Ballanca ndërhyr dhe shprehet se proces-verbalet nuk i kishim në rendin e ditës, kryetar.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani vijon duke u shprehur se nuk është çështje por e trajtojmë në fund.

Anëtarët e Këshillit nuk shprehin kundërshtime mbi rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen më çështjen e parë të rendit të ditës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se lidhur me listën përfundimtare për renditjen e kandidatëve Këshilli, siç jeni në dijeni, në fakt është bërë dhe publike, bëri e pikëzimin të kandidatëve pasi i bisedoj rastet njeri pas tjetrit dhe sipas procedurës, mbi bazën e këtij pikëzimi dhe gjithë arsyetimet që u bënë janë përgatitur praktikisht vendimet tona të vlerësimit për secilin kandidat, të cilat, në këtë rast janë bërë dhe me shpejt se herët e tjera, sepse kemi tashmë përvojë dhe janë thjesht në momentin e redaktimit të gabimeve ortografike të fundit. Së dyti në procesin e zbardhjes, mund ta parashtrojë edhe znj. Margarita, u konstatua një gabim matematikor për kandidaten Joana Asimi Sorraj, pikëzimi nuk duhet të ishte 82.5 por 82.2 dhe njëkohësisht po të fleta e saj që, do të ishte një gjë pak paradoksale, kemi bërë gabimisht një herës me 6 në dy komponentë, por që në fakt nuk është reflektuar në llogaritjen përfundimtare, vetëm në atë të komponent. Duke qenë se punojmë me linja vertikale ka pasur një herëz të gabuar por që nuk ka ndikuar as në atë që kemi shpallur. Është i vetmi nga dokumentet tona të zbardhura që kemi firmosur atë ditë që duhet korrigjuar në tabelën që bëhet publike. Pra është herësi tek “vizioni” dhe “aftësia për të vepruar”, aty kishim bërë një gabim. Të paktën kjo na del dhe në një nga qëllimet diskutimit të listës përfundimtare të renditjes së kandidatëve është që pasi është vendosur pikëzimi, është për të parë, e kemi të shprehur aktet tona nënligjore normative, e për të verifikuar dhe gabimet e natyrës aritmetikore dhe që në këtë rast u verifikua një i tillë. Pra ka vetëm një ndryshim nga rastet e tjera apo jo znj. Margarita?

Margarita Buhali, relatores e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, merr fjalën dhe sqaron se unë e bëra të ditur që atë ditë në momentin e konstatimit, në momentin e arsyetimit dhe ishte një gabim vërtetë aq i dukshëm sepse 411 ishte mbledhja totale pjesëtim për 5 dhe përfundimi ishte 82.5, gjë që nuk kishte mundësi të ndodhte. Të dhënat nuk ndryshojnë sepse ishte bërë gabim në pjesëtim dhe tek ajo komponenti i zërave sepse nuk përkonin me atë që ishin dhënë. Ndoshta është bërë gabimi dhe për shkak të idesë se mund të ishte dhe znj.Arta, pro të jemi gjashtë anëtarë por në fakt ishim pesë. Siç ishim dhe në mbledhjen që u tërhoqëm për të bërë pikëzimin. Kështu unë ja u vura në dijeni që atë dite kur ju nisa dhe materialet e arsyetimit të vendimit. Nuk kam gjë tjetër për të shtuar.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani vijon duke u shprehur se edhe unë për këtë doja të shpreheshja për momentin e parë. Kemi ndonjë gjë për të diskutuar për listën e pikëve, ju i kini përpara po e shikoni. Kemi ndonjë diskutim për pjesën e miratimit të listës? Jo. Znj. Erinda ndonjë diskutim ?

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se unë kam një kopje të vendimit, e cila është me një renditje, pa dokumente bashkëlidhur dhe pa shkaqe për të cilat është ai rezultat dhe ai vendim që Këshilli e ka marrë në dhomë këshillimi. Ne përsëri nuk pamë një njoftim të shprehur që Këshilli është në dhomë këshillimi, pra njoftimi për mbledhje, i cili për gjykimin tonë duhet të bëhet me dije për publikun. E kemi thënë këtë edhe në proceset e mëparshme, nuk është realizuar edhe për këtë herë. Çka për ne që të bëhet një vendim pa një mbledhje na duket pak jo transparente dhe e çuditshme që mund të krijoj problematika në perceptimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e Këshillit për sa i përket pikëzimit. Ky është qëndrimi ynë. Aktet e vlerësimit edhe sot para mbledhjes nuk ndodheshin të publikuara në faqen zyrtare, i verifikova edhe para se të vija këtu dhe nuk ishin të botuara dhe publikuara dhe ende nuk kemi marrë një kopje të akteve të vlerësimit dhe ne nuk mund të shprehemi me saktësinë apo jo të listës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet Znj.Mimoza Arbi ndonjë diskutim ?

Mimoza Arbi merr fjalën dhe shprehet se nuk kam ndonjë diskutim.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se ky është një diskutim që znj.Erinda e ka ngritur që herën e kaluar dhe mbaj mend që ne kemi atë interpretimin se ne jemi të mbledhur në çdo kohë dhe rezultati si të thuash mund të dali në çdo kohë

Erinda Ballanca ndërhyt dhe shprehet se z.Kryetar unë kisha shpresuar që pavarësisht idesë tuaj të dhomës së këshillimit apo të bisedimeve...

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se jemi të mbledhur për këtë 10 ditësh, jemi ligjërisht të mbledhur.

Erinda Ballanca vijon duke u shprehur se jam dakord, por publiku nuk kupton konceptin e dhomës së këshillimit. Qëllimi i njoftimeve është bërja e transparencës për publikun, për të kuptuar se çfarë po ndodh. Vetë ligji thotë behet nëpërmjet një procesi publik dhe transparent, sipas një procedure transparente dhe publike, në bazë të pikës 4 të nenit 147/d të Kushtetutës dhe sigurisht procedura që Këshilli kryhen njëherë ose njëherë tjetër nuk mund të jetë tërësisht e pa të metë. Ne mundohemi dhe gjejmë ato problematika të cilat i evidentojmë gjatë kryerjes së veprimtarisë të cilat mund të adresohen në rastin tjetër apo në vlerësimin tjetër. Unë kisha menduar që përtej qëllimit tim parimor për sa i përket ekzistencës apo jo të dhomës së këshillimit, ndoshta çështja e njoftimit të këtij fakti mund të ishte bërë e mundur publike që të ishin në dijeni kandidatet, qytetaret dhe ne gjithashtu, që vlerësimi ishte duke u kryer. Në logjikën tonë pa një njoftim për një mbledhje nuk mund të këtë përfundim të

vlerësimit. Kjo është logjika dhe ky është interpretimi që në kemi për këtë dispozitë dhe këtë klauzolë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shtron për diskutim projektvendimin mbi raportin e arsyetuar që i përket pikës tjetër të rendit të ditës duke u shprehur se vendimi tjetër, sikurse e parashikon ligji, është shqyrtimi dhe miratimi i raportit për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Edhe për këtë raport kemi ndjekur modelin që përdorëm, të paktën sa më takon mua nga ky pozicion që jam, modelin që është përdorur në rastin e Gjykatës Kushtetuese, znj. Margarita mund ta shpjegojë më me hollësi. Ajo që ne ndoqëm herën e kaluar si model dhe që ramë dakord ishte që të mos japim arsyetimet të hollësishme në këtë raport lidhur me vlerësimin komponent pas komponenti dhe kandidat pas kandidati, duke bërë krahasime me njëri tjetrin dhe gjëra të tjera, ato i kemi të pasqyruar në mënyrë shumë të detajuar në vendimet individuale për secilin nga kandidatet.

Margarita Buhali, relatore e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, merr fjalën dhe sqaron se ky ishte qëndrimi që unë mbajta. Ne kemi bërë goxha debat herën e kaluar për pjesën dhe mënyrën se si do ta bënim raportin dhe si e parashikonte ligji dhe vendosëm të ishte kjo mënyra, domethënë duke qenë se ishte më shumë një rezymë e punës që ne kemi bërë dhe i rezultateve finale të të gjithë kandidatëve, ndërkohë që do mbetej vlerësimi i secilit për kualifikimet përkatëse tek vendimet. Raporti ka pak a shumë referencë te vendimet për atë pjesë. Kështu u la prandaj u ndoq e njëjta procedurë edhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe sqaron se këtu e kemi reflektuar, të paktën kur të miratohet, sepse dokumenti kur është shpërndarë tek kandidatja Joana Asimi ka qenë me 82.5, kurse këtu reflektohet ndryshimi. Të paktën sipas orientimit tënd znj. Margarita këtu është reflektuar tek kopja e fundit dhe me sa vë re e kanë bërë edhe korrigjimin. Diskutim tjetër nga koleget? Jo. Znj. Erinda ndonjë diskutim ?

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se, së pari me falni për referencën e faqeve sepse unë e kam printuar të zmadhuar nuk mund ti referohem ekzakhtësisht faqeve se ku ndodhet, por në paragrafin “sipas ligjit jo vetëm në vlerësimi individual i secilit kandidat por dhe renditja e tyre përfundimtarë nuk realizohen nëpërmjet procesit të krahasimit të meritave të kandidateve përkundëj njeri-tjetrit. Për rrjedhojë dhe arsyetimi i raportit lidhur me renditjen e kandidateve nuk mund të përmbaj konstatime ose opinione të natyrës krahasuese nëpërmjet kandidateve. Ligji nuk i njej KED asnjë kompetencë apo diskrecion të tillë”. Unë kam një pyetje se mbi çfarë bazash është bërë ky lloj vlerësimi për sa kohe që renditja, detyra

kryesore e Këshillit është renditja. Renditja do të thotë krahasimi midis të njëjtave kritere që ka përcaktuar ligji, nuk ka mundësi tjetër në gjykimin tim. Pra nëse ju thoni që nuk ka kompetencë krahasimi, renditja është krahasim, pa diskutim, që për këto kritere që ka përcaktuar ligji kemi thënë ky individ renditet më lart për shkak të këtyre kritereve që ka përcaktuar ligji . Se ai mund të jetë një profesionist shumë i mirë, por ligji ka përcaktuar disa kritere të caktuara. Kjo ishte një nga konstatimet që unë nuk e gjej në përputhje me ligjin në frymën me ligjin , kush e lexon mua me bëri problem ky si konstatim. Mund ti them të gjitha njëherazi apo një nga një ?

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe sqaron se mund të veprojë si ta vlerësojë.

Erinda Ballanca vijon fjalën dhe shprehet se, mund t'ju a jap për lehtësi më vonë pasi i kam printuar me germa te mëdhaja dhe nuk mund tu them si faqe. Gjithashtu në përfundim të kësaj pjese arsyetuese thuhet “nisur nga këto veçanti procedurës se vlerësimit pasqyrimi në këtë raport çfarëdo forme përmbajtje të arsyetimit shumë të hollësishëm që përmbajnë vetë vendime përkatëse të vlerësimit dhe pikëzimit në vend të lehtësimit të punës Kuvendit si organ mbështetës dhe transparent do provonte efektin e kundërt”. Prezumohet në këtë raport se janë publike kopjet e vendimeve e procedurës së vlerësimit, ç’ka nuk është një fakt i vërtetë. Unë i kam verifikuar dhe jo vetëm që nuk më kanë ardhur, nuk më janë komunikuar dhe presupozoj që sa nuk më janë komunikuar nuk duhet të jenë gati ose do të ishin publike këtë kam presupozuar. Sigurisht ka raste për të cilat parashikohet shprehimisht komunikimi i dokumenteve pranë institucionit të Avokatit të Popullit, ka raste nëpërmjet faqes ato janë publike dhe bëhen publike për të gjithë jo vetëm pre mua si institucion. Ende deri në këtë moment që flasim nuk kam parë as edhe një lloj arsyetim të hollësishëm në lidhje me përmbajtjen, me aktet e vlerësimit. Kështu që besoj që pa pasur ato dokumente ky akt na del i paarsyetuar praktikisht fare sepse bëjmë referencë në një arsyetim që deri më sot nuk është i formëzuar .

Gjithashtu kemi bërë dhe një shënim i cili unë gjykoj dhe propozoj Këshillit që ta rishikoj dhe njëherë, ta vlerësojë. Ndoshta ka mbetur i tillë nga rastet e vlerësimeve apo të raportit vlerësues që ka qenë për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese . Aty ku Këshilli i referohet që “për realizimin e procedurave të verifikimit të kandidaturave përveç veprimeve verifikuese të kryera nga vetë Këshilli bazuar në informacionin e hollësishëm dhe voluminoz të dërguar nga institucioni publik dhe privat në bazë të kërkesave të Këshillit, ushtrimi i kontrollit të thelluara për pasurin integritetin dhe kushtet e tjera është realizuar është nga disa institucione të tjera ILDKPI, DSIK, Agjentit Informative, Ministria e Brendshme, AIDSSH,

KLJGJ, KLP e të tjera të cilat i kanë sjellë këshillit raportet të dhënave dhe gjendjen përkatëse”. Sa i përket agjencive informative, nëse ju a ka sjellë, për ne është ok . Por me sa kam dëgjuar unë në këtë mbledhje, aq më tepër për inspektorin që ka një përcaktim të qartë dhe ajo nuk është shprehur në asnjë nga shkresat në lidhje me këtë kriter dhe besoj që Këshilli lidhur me këtë çështje duhet të tregoj të vërtetën. Ata mund të mos na kthejnë përgjigjen, por këtu arsyetimi i Këshillit duhet të jetë i tillë që duhet të tregoj atë që është realiteti i faktit që nga agjencitë informative nuk është sjellë asnjë informacion pranë Këshillit. Të paketën dijenia time është kjo, DSIK ka sjellë dhe është gjë tjetër, dhe ne nuk mund të themi se ata kanë realizuar një kontroll. S’kemi asnjë dijeni përderisa nuk kanë sjellë asnjë dokument e një informacion tek ju, unë besoj se në arsyetim kjo gjë duhet të dalë, duhet të evidentohet. Më tepër se çdo gjë për faktin e të vërtetës sepse po ta kishin sjellë, cilido të ishte ,qoftë dhe i rezervuar, që mund të këtë qenë një informacion sekret dhe nuk mund të bëhet publik ishte gjë tjetër. Në dijeninë time nuk është sjellë asnjë informacion, nuk e di nga Ministria e Brendshme çfarë informacioni është sjellë, unë në letrat e mija nuk kam pasur asnjë informacion në lidhje me ato që na keni dërguar, kjo në lidhje me informacionet e kërkuara nga Ministria e Brendshme. Prandaj ndoshta do të ishte mire që në lidhje me këtë pikë të reflektohet set kush ka sjellë dhe kush nuk ka sjellë është gjë tjetër. Të sjellë në vëmendje sepse ka një parashikim të posaçme për sa i përket ILD-ës që nuk është mundur, në gjykimin tonë, të verifikohet nga ana e KED-ës, jo për fajet e veta.

Më tej do të propozoj të bëhet një referencë, në përfundim kur japin të gjithë faktet që kemi bërë ndalimet, të bëjmë një parashikim dhe të themi që arsyetimet këtyre vendimmarrjeve nuk janë të përfshira sepse janë të publikuara në faqet zyrtare. Kjo për ti qenë korrekt ligjit sepse ligji përcakton dhe thotë... e di që janë të publikuara, por kjo është për efekt të leximit të tekstit është thjesht propozim se nuk është se nuk janë të publikuara. Se ka një parashikim ligjor i cili thotë se duhet të arsyetojmë dhe të publikojmë dhe përjashtimet tek ky raporti dhe të përmbaj listën e tyre. Duke qenë se s’kemi arsyetim këtu, duke përdorur të njëjtin format duhet të themi arsyetimet janë në vendimet përkatëse të identifikuar dhe të komunikuar për secilin nga kandidatet. Nëse është bërë ankim në këto vendime ose nëse nuk janë ankimuar, është vetëm çështje fakti. Këto janë propozime pasi teksti është shumë i kurrar.

Margarita Buhali, relatore e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndërhyr dhe sqaron se duhet nisur dhe nga fakti se nuk kemi pasur asnjë ankim.

Erinda Ballanca vijon fjalën dhe shprehet se shumë mire por është fakt pozitiv për ta shënuar, në qoftë se ka, është më tepër si çështje fakti. Më tej në përfundim pasi mbarojmë

emërtimet në përfundim të procedurave të verifikimit dhe të plotësimit të kushteve ka vendosur lejimin e këtyre 5 kandidatëve, dy paragrafë më poshtë është një *types* dhe shkruhet “për këtë qëllim me vendimet 145 146 dhe 146 “ do të jetë gabim në shkrim . Edhe këtu në shprehjen “miratojnë ekspertet”, një ekspert kishim.

Pastaj unë kam një problem thelbësor me gjithë procedurën dhe me faktin e miratimit të raportit apo jo që ka të bëjë me afatet dhe me mundësinë që ky Këshill si njeri nga organet që duhet të veprojë së bashku me organet, duke bashkërenduar punën bashkë me organet e tjera për ti dhënë vendit një Inspektor të Lartë të Drejtësisë, duhet ti krijojë kushte Kuvendit për të pasur mundësi për ta kryer dhe ai procedurën e vetë në përputhjen me ligjin. Kuvendi aktualisht nuk është në sesion. Ka një parashikim që duhet të shprehë vullnetin e tij për 30 dite dhe nëse nuk e shpreh konsiderohet se fillon veprimi i mekanizmit deadlock . Qëndrimi i Kuvendit ka qenë i ndryshëm nga qëndrimi personalisht kam pasur lidhje me këtë çështje dhe do doja që, në gjykimin tim, duhet tu jepet mundësia organeve të emërtesës për ta ushtruar kompetencën e tyre në mënyrën më të gjërë të mundshme. Çfarë do ndodhi nëse ky Këshill do të dërgonte dokumentacionin dhe Kuvendi nuk është i mbledhur dhe kalon afati 30 ditor? Për me tepër sjell në vëmendje që nuk do të jetë më në funksion ky Këshill por do të ketë një anëtarësim të ri, i cili mund të ketë një qëndrim ose vendimmarrje tjetër. Ndaj do të ishte mirë që të trajtohej dhe kjo çështje, të gjendej një mënyre për ta zgjidhur këtë problematikë. Këto ishin komentet e mija sa i përket raportit.

Sigurisht që dua ta vlerësoj maksimalisht punën e bërë për këtë procedurë sepse ka qenë vërtet një punë voluminoze dhe vendimmarrja për hir të së vërtetës gjykoj ka qenë, për sa i përket pjesës së parë kur unë kam marrë pjesë, pjesës së verifikimit se në vlerësim nuk kemi marrë pjesë, unë kam ndarë të njëjtat mendime, pjesërisht kam pasur nja dy mendime të shumë të vogla ndryshe por prapë mendoj se Këshilli ka marrë vendime të drejta për sa i përket procedurës së verifikimit duke shkuar drejt asaj të funksionalitetit, pra duke zbatuar parimin e funksionalitetit duke kryer procedurat brenda një afati sa më të përshtatëm të mundshëm .

Margarita Buhali, relatore e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, merr fjalën dhe duke e falënderuar shumë Avokaten e Popullit për gjithë këtë seriozitet, si dhe për detajet që i ka kushtuar raportit, sqaron se është e vërtetë që mund të ketë qenë me një qëndrim ndryshe, por gjithmonë e kemi mbajtur në konsideratë për të ecur në të njëjtën rrugë. Këshilli vendosi dhe u la ai model raporti që është ky i tanishëm. Unë vlerësoj që nuk mund të dalim nga shinat.

Për sa i përket pjesës, ka një të drejtë, normalisht duhet të ishin dhe vendimet e vlerësimit por them që personalisht kam punuar në kohë rekord për këtë pjesë, duke pasur në konsideratë që afatet e ligjit për Inspektorin janë shumë strikte dhe ndoshta për nevojën imediate që kanë qytetaret për të marrë përgjigjen në kohë për ankesat e tyre. Dhe ne dijeninë time janë thjesht për korrigjim gabimesh tek pjesa e këshilltarëve. Unë për veten time i kam dërguar, që ditën e shtunë, ka qenë ditë pushimi, kjo është ndoshta arsyeja që nuk ishin bërë deri tani.

Për i përket pjesës që ka të bëjë me bashkëpunëtorët duke qenë së në një pjese që ishte kandidati Artur Metani, pra ishin të raundit të parë, sepse ky proces është në ndryshim nga ai i Gjykatës Kushtetuese, sepse u ribë gjatë gjithë mandatit tonë dy herë, u arrit që të bëhej pjesa tjerët nuk u ribë dot. U kthye përgjigje se nuk kishte të dhëna të tjera. Ndërkohë për të tjerët shkresa jonë ishte e detajuar u kthye një përgjigje se nuk kemi të dhëna nuk është se ishte e detajuar, ajo që thoni ju qëndron, por duke qenë se ishin dy qëndrime ne vendosëm një parashikim të tillë të përgjithshëm

Erinda Ballanca ndërhyr dhe pyet se ka ardhur nga DSIK-ja apo nga agjencitë ?

Margarita Buhali, relatores e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përgjigjet se komunikimi jonë ishte nëpërmjet DSIK. Kuvendit do ti shkojnë të gjitha materialet që në i kemi marrë dhe besoj se ata do ti kenë përpara. Kjo ishte mënyra e të shkruarit sepse avokatja thotë ju i keni kërkuar ata nuk kanë kthyer përgjigje .

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyr dhe shprehet që ne i kërkuar dhe i kërkojmë nëpërmjet tyre (DSIK)

Erinda Ballanca ndërhyr dhe shprehet se ata kanë kthyer përgjigje dhe kanë bërë kontrollin. Ne nuk kemi dijeni që ata kanë bërë kontrollin. Të paktën nga aktet që unë kam marrë, nuk kam as një dijeni se ata e kanë bërë. DSIK-ja është tjetër ne po flasim për agjencitë, është e shkruar që kontrolli është bërë nga agjencitë e shërbimeve. Nëse ju i keni marre është gjë tjetër, nëse s'kemi marrë Jam e bindur që e keni bërë këtë gjë se e kam parë shkresën. Përveç te tjerave është shumë e rëndësishme në gjykimin tim. është shumë e rëndësishme që ne ose Këshilli të tregojë këtë që ka ndodhur dhe për ndonjë problematikë që ka lindur. Ata kanë synimet dhe qëllimet e tyre ama Këshilli e ka bërë punën e vetë për të kërkuar kontrollin e këtyre organeve që është një gjë e ndryshme, edhe për efekte përgjegjësie, mendoj unë, megjithatë ju e dini vetë sepse përgjegjësia parësore është tek ju .

Margarita Buhali, relatores e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vijon me sqarimet duke u shprehur se është pjesa tjetër që ju diskutuat për pjesën e mendimit të ndalimeve, patjetër mund të bëhet një referencë sepse ato tashmë janë të publikuara, për më

tepër janë më vendime të formës së prerë. Sepse kanë një specifik që duhet të arsyetohet edhe për kandidatet e përjashtuar. Në fakt ajo nuk më duket se ka të bëjë shumë me të ndaluarit, më duket se ka të bëjë me të përjashtuarit nga lista prej 5 anëtarësh, megjithatë nuk ka problem. Ne nuk kemi përjashtuar njeri. Në 5 kandidatë na ngelen dhe në 5 sollëm për vlerësim dhe renditje.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe sqaron se për punën e komunikimit me agjencitë informative. Ne e kemi ndarë që në Maj këtë procedurë. Dhe më duket se është një diskutim që e përsërisim prapë. Pasi agjencitë informative, jo thjesht për Inspektorin, por dhe për Gjykatën Kushtetuese, nuk pranuan të komunikonin drejtpërdrejt me Këshillin, zgjidhja që u gjet ishte ta merrnim nëpërmjet DSIK. Dhe e kemi bërë që në muajin Maj dhe është e njëjta praktikë edhe në këtë rast. Kemi kërkuar ndihmë administrative për ta marrë, për ta përpunuar dhe për ta përcjellë informacionin e Agjencie Informative. Dhe i kemi marrë përgjigjet nga DSIK. Me aq sa unë jam në dijeni, me aq sa unë mund të di modestisht, nuk është se DSIK ka informacionet je apo nuk je agjent i shërbimeve, ata këtë informacion e kërkojnë nga autoriteti. Tani a e ka kërkuar apo jo, unë mendoj se e ka kërkuar sepse nuk mund të mendoj se nuk e ka kërkuar sepse është e vetmja mënyrë par ta marrë. Dhe unë nuk jam në zyrat e tyre, nuk i di metodat e punës por di që është përgjegjësia e tyre që të na ofrojnë ndihmën administrative ashtu siç e kemi kërkuar ne: për të komunikuar me autoritetet dhe për të na përcjellë informacionin sipas ligjit. Ne këto përgjigje i kemi marrë, Kjo ka qenë mënyra. Dhe ne mund ta përmendim këtu në raport, mund ta modifikojmë e të themi që DSIK në formën e ndihmës administrative na e ka sjellë dhe prej tyre ,siç edhe ka ndodhur realisht. Unë e bëra një shënim, që të shtojmë ndihmën administrative.

Nga Ministria e Brendshme i kemi marrë, kanë ardhur nga SHÇKBA, ata e kanë sjellë informacionin për të gjithë . Por problemi është se ato nuk u shpërndanë për ju sepse i sillnin me shënim si të klasifikuar ndonëse aty shkruhej që nuk kemi të dhëna dhe kandidati është në rregull....

Erinda Ballanca ndërhyr dhe shprehet se merakun im i vetëm ka lidhje me terminologjinë e përdorur sepse kush lexon thotë që ne garantojmë se janë ushtruar kontrollet e thelluara, për pasurinë po na ka ardhur raporti, për DSIK po se ka ardhur letra. Për agjencitë informative nuk di a keni apo nuk keni letër, unë e di që s'keni. Unë e kam realisht problem çështjen e bashkëpunëtorëve

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe vijon të sqarojë se mund ta zgjerojmë pak këtu sepse në çdo vendim verifikimi e ka të shkruar këtë arsyetim, ka ndodhur kjo gjë, është kërkuar ndihma administrative në datën kaq, ka ardhur përgjigja në datën kaq.

Megjithatë po e marre dhe po e vendos këtu si fenomen. Në përgjigjet për çështjen e qenies agjent apo bashkëpunor i kanë të tëra të cituara çfarë i kemi kërkuar dhe na kanë thënë në bazë të pikës tuaj 49 me sa mbaj mend apo 59 nuk ka të dhëna të kësaj natyre.....

Erinda Ballanca ndërhyr dhe shprehet se kjo është çështje që duhet ta drejtojmë dhe të rregullojmë ligjin ose ta heqim si kompetencë nga KED-ja. I bëjmë këto pyetje se janë problematika të cilat do ti adresoj në raportin tim.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe vijon të sqarojë se po të jetë për ligjin, në deri diku, edhe siç e kemi biseduar në Këshill, kemi thënë për Kuvendin që duhet të shtojmë dispozita se nevojitet edhe tek kontrolli i pasurisë. Po të lexoj vetëm thjeshtë ligjin, unë duhet të marr vetëm raportin e ILDKP dhe të mos bëj asgjë. Tani duhet të vepronim në këtë mënyrë ne? Në ligj nuk e kam të shkruar. Aty thotë merr raportin dhe vendos. E kuptoni? Ka edhe shumë elementë të tjerë. Kjo që është një temë diskutimi tjetër, që mund të zgjati, është që ligji duhet të parashikojë për KED atë që ka për organet e rivlerësimit kalimtar, edhe komunikimin me agjencitë. Prandaj nuk komunikojnë vetë drejtpërdrejt sepse nuk e kishin të qartë në ligj. Mund të them që edhe ndonjë nga bankat, herën e parë, nguroi të na jepte përgjigje sepse më thonin është sekret bankar dhe ku e kam unë në ligj që duhet të jap ty informacion. Por ne e kishim mirëmenduar që në fillim që morëm deklaratat personale subjekteve që na autorizuan që u gjet zgjidhje sepse ata thoshin ne nuk e kemi të shkruar. Pra po ti hysh ligjit kam edhe unë, por mire bërë që e ngrite, kam dhe unë plot gjëra se si mund ti plotësohet ai ligj që ky organ normalisht ta mare informacionin pa probleme dhe ndoshta diçka më shumë sipas meje.

Për sa i perket krahasimit të kandidateve, në bëjmë një koment aty që dhe mund të mos e bënim dhe fare, pasi mund të kemi dhe këndvështrime të ndryshme. Por mënyra se si është dizenuar KED nuk është të përzgjedhë 5 kandidatë por të vlerësojë secilin kandidat sepse po ta kem unë këtë si autoritet mua më duket, mua personalisht, se unë praktikisht, *de facto*, po i them organet e emërtesës unë i krahasova të gjithë këta që kam ne shportë dhe piket ua vendos për ti krahasuar me njeri tjetrin dhe se kush është ai që unë mendoj se është më i miri . Në fakt zgjedhjen midis atyre të renditur mendoj unë e ka organi i emërtesës . Ne ajo që themi këtu është ne nuk i krahasojmë me njeri tjetrin kandidatet. Unë për veten time nuk guxoj ta bej këtë gjë se nuk e kam këtë autoritet nga ligji. Unë marr dhe vlerësoj individualisht secilin se çfarë meritash ka secili me vete . Dhe sfida e çdo anëtari të KED është njësoj, si në gjykim edhe në hetim, që pavarësisht se çfarë mendoj unë për ata që janë në komunitet, unë jam i detyruar të jem objektiv dhe ti vendos pikët kandidatit sipas meritave të tij individuale, jo duke krahasuar me meritat e tjetrit. Dhe ne këtë kemi bërë me njeri-

tjetrin. Ne e kemi mare kandidatin dhe e kemi skanuar individualisht, kriter mbas kriteri, secili nga ne thotë mendimin e vet, krijohet debat dhe në fund del arsyetimi që në këtë rast zonja Margarita i ka përmbledhur dhe del ndarja e pikëve mesatare. Dhe ne i marrim kandidat pas kandidati. Prandaj e themi që nuk jemi nisur nga krahasimi, i marrim individualisht, prandaj e vendosim këtë gjë. Dhe unë them që kjo është qëllimi i ligjit. Renditja si del me pyetët? Me të drejtë. Renditja del nga pikët dhe në nuk bëjmë llogari paraprake. Madje po ti shikoni kishim dhe një gabim matematikor sepse ne i mbledhim në fund, ne nuk i mbledhim fare të dhënat për të pare sa ka njeri për të kaluar të tjetri. Ne i mbarojmë në linje horizontale, kriter pas kriteri, kandidat pas kandidati dhe në fund fare del rezultati, ai që del. Mendoj se kemi qenë më të përgjegjshëm në këtë pikë sa nuk ka ku të shkoj më. Si mund të shkruaj unë që p.sh., mendoj se Artur Metani është më i mirë se Sokol Stojani ? Unë nuk mund ta shkruaj këtë gjë në vendim sepse unë do shkruaj vendimin dhe do ta arsyetoj. Si do të them me duket ky më mirë se te tjerët. Unë këtë nuk mund ta them. Unë them për merita profesionale, kriter pas kriteri, të vlerësoj me kaq. Kuvendi ka nxjerr një sistem pikëzimi, sepse po të mos ishte ai sistemi i pikëzimit do të ishte ajo që thua ti, do të ishte një diskutim krejt tjerë sepse nuk do të kishte pikë objektive, atëherë do të më thojë me të drejtë si e nxore që ky është i pari. pra do të kishte pasur një mënyrë tjetër për të punuar . Sugjerimet që bëtë për të bërë referencat unë kam përshtypjen që diku është bërë, por në tërësi, ku referohemi që vendimet janë të publikuara, por mund ta bëjmë pak më të detajuara dhe për vendimet e verifikimit që janë në faqe.

Për metodën e hartimit të raportit. Ne e kemi diskutuar që herën e kaluar. Dy mënyra do kishte ose raporti do ishte 200 faqe apo 100 faqe mesatarisht sepse vetë vendimet janë 20 faqe për çdo vlerësim dhe aty ne do të kopjonim praktikisht sepse nuk kishim çfare të arsyetojmë në raport përtej fakti që ne e kemi të arsyetuar hollësisht edhe në vendimet tona. Vendimet tona ne pretendojmë që janë shumë të detajuara në arsyetim dhe çfarë do të bënim ne do të merrnim ti kopjonim arsyetimet dhe do ti vendosim në raport. Kemi thënë që ne nuk do ndalojmë në detajet e arsyetimit sepse gjithë arsyetimi për secilin kandidat e kemi bërë në vendime të cilat janë bashkëlidhur raportit dhe janë dhe publike. Tani ka dy mënyra për të miratuar raportin ose kur të behet publike vendimi, ose ne praktikisht e kemi vendosur pikët dhe pikët nuk i kemi vendosur për çështje numrash. Ne nuk numërojmë gjë, ne bëjmë vlerësimin dhe vlerësimi është konvertuar në numra dhe ne e dimë arsyetimin se kush do të jetë. Për këtë arsye mund të ishte një zgjidhje, po t'ia kishim dale të premtën dhe ato mund të ishin publikuar. Nuk ja dolëm praktikisht do të mbarojmë korrigjimet sot edhe to nesër janë publike dhe do të dalin aty bashkë me raportin.

Për ekspertin znj. Erinda me të drejtë e shtron pasi e kemi lënë në shumës, ka qenë në tentativë mundësia për dy por ngeli vetëm një ekspert.

Sa i përket afatit për 30 ditëshit ne tani kemi dy afate. Unë e kuptoj që Kuvendi nuk është i mbledhur....

Mimoza Arbi ndërhyt dhe shprehet se ne kemi një Rregullore dhe Kuvendi funksionon me sesione. Sesionit i Janarit fillon javën e tretë pra ditën e hënë i bie data 20 dhe është seanca e parë. Kuvendi aktualisht nuk është në sesion. U mbyll më datën 18 dhe fillon sesioni tjetër në 20 Janar. Kjo është një periudhë vakuum, në kuptimin e veprimtarisë së Kuvendit, pra nuk funksionojnë as komisionet, nuk funksionon as seanca.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe pyet keni mundësi? D.m.th., kjo lloj procedure, vlerësimi dhe zgjedhje a përfshihet apo a përjashtohet nga mundësia që Kuvendi të mbledhet para fillimit të njësonit ?

Mimoza Arbi ndërhyt dhe shprehet se ajo mbetet në diskutim por sipas Rregullores Kuvendi nuk mbledhet....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se unë di që mund të mbledhet dhe jashtë sesioneve Kuvendi, por nuk e kujtoj për çfarë .

Mimoza Arbi merr fjalën dhe shprehet se Kuvendi mbledhet në raste të përcaktuara. Por që komisioni të fillojë mbledhjen për një seancë dëgjimore, duhet të fillojë sesioni. Nuk mund të mbledhet komisioni jashtë sesionit....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se thjesht po pyes a përfshihet në ato raste që mund të mbledhet në mënyrë të jashtëzakonshme dhe të bëj procedurën apo jo? Në qoftë se nuk përfshihet është një diskutim tjetër në çohet se përfshihet.

Mimoza Arbi merr fjalën dhe shprehet se mbledhet në raste të caktuara.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se ndoshta zonja Arbi e di më mirë se sa ne të tjerët. Por unë mbaj mend rastin kur janë përzgjedhur anëtarët e komisionit të vetingut që ka qenë dhe ai një rast përjashtimor dhe ne të cilën duhet të kishte dhe vendimmarrje dhe nga ana e komisionit. Dhe mbaj mend që në atë kohë që do duhej vendimmarrja e komisionit të jetë bërë në një kohë që kuvendi nuk ka qenë në mbledhje. Kështu ka ndodhur ishte Qershor, ishte koha e zgjedhjeve dhe ishte fare i mbyllur. Kanë bërë seance por dhe duhet të kenë bërë dhe në komision mbledhje .

Mimoza Arbi merr fjalën dhe shprehet se në rastin e organeve të vetingut komisioni që funksiononin ishin komisione *ad hoc* të ngritur në bazë të ligjit si komisione të posaçme. Në rast të veprimtarisë së komisioneve ajo fillon kur çelet sesioni, miratohet , miratohen

punimet dhe të vetmet komisione që mund të funksionojnë janë komisionet e posaçme. Nuk e di në këtë rast, duhet të jetë vendimtarja e Kuvendit, nuk mund të shprehem unë .

Vitore Tusha merr fjalën dhe pyet se cila është kërkesa juaj si Kuvend në këtë rast ? Ju po e bëni publike çështjen, na e prezantoni se çfarë mund të bëjmë në këtë rast.

Mimoza Arbi merr fjalën dhe shprehet se ne kërkonim mundësinë e një afati kohor, në momentin e çeljes së sesionit që është java e tretë e Janarit dhe i bie data 20, Kuvendit do ti behet me dije ardhja e raportit dhe vendimeve që merr KED për ILD dhe mbi bazë e saj fillon veprimtaria dhe ajo mund të behet shumë shpejt, me seance jashtë radhe apo të pa planifikuar Kuvendi mund ta bëjë pa problem .

Vitore Tusha merr fjalën dhe shprehet se pyetja ime ishte sa mundësi ligjore dhe kushtetuese kemi ne ti japim afat Kuvendit? Afatin e jep ligji, Kushtetuta. Ne e kemi vonuar sigurisht por ne kemi bërë detyrën gjatë gjithë vitit me shpallje, rishpallje në përpjekje për ta bërë sa më shpejt dhe deri këtu finalizohet veprimtaria jonë. Prandaj shtrohet pyetja se çfarë mund të bëjmë ne më tej?

Mimoza Arbi merr fjalën dhe shprehet se thjesht ju vura në dijeni për këtë procedure të veçantë që ka Kuvendi, të parashikuar në Rregulloren e tij për sesionet, kur mbarojnë sesionet dhe kur fillon sesioni tjetër dhe për këtë ju vura në dijeni. Vendimmarja është e juaja dhe masat e tjera do ti marrim ne. Rregullorja e Kuvendit është ligj .

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se ne kemi dy afate në këtë rast. Një 10 ditor është ai që Këshilli qëndron, është i mbledhur dhe duhet të bëjë renditjen. Po e lëmë k për një çast këtë. Kemi dhe një afat tjetër, e ka specifik ligji për ILD , që brenda tre ditëve nga miratimi i renditjes dhe i raportit duhet ti përcillet Kuvendit lista e kandidatëve bashke me raportin e arsyetuar. Është dhe dokumentacioni që ne e kemi gati. Ky është një problem tjetër. Gjithsesi ne brenda tre ditësh, nëse e vendosim sot, duke parë kalendarin në datën 26 duhet ti përcillen Kuvendit, duke parë kalendarin. Afti 30 ditor për ju përfundon në datë 25 Janar që është dita e shtune. Pra Kuvendi brenda javës duhet që ta fillojë e ta mbylli procesin . Pra nga data 20 deri më datën 24. Nuk dua të hyj në punët e Kuvendit, po shikoj kalendarin, se nuk i gjykoj unë .

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe shprehet se organi i emërtesës është Kuvendi, nuk është Kryetari i tij apo jo? Dhe këtu të dyja forcat politike, kështu e ka ligji, duhet të ishin prezent, si shumica si opozita. A duhet të mblidhet, a do të mblidhet, a i duhet një vendim Kuvendi apo një vendim byroje të Kuvendit që të mblidhet dhe jashtë sesionit, t'ia bëjë gati Kuvendit për seancë. Po flasim që mos nuk i ngelet Kuvendit kohë për të shqyrtuar kandidaturat se do ti marrë të 5 në intervistë, të bëjë vlerësimin etj., kjo është e gjitha gjëja.

Por që është braktisur kjo mbledhje nga kryetari i komisionit të ligjeve nuk kam frikë t'ia them dhe atij përpara, që në Mars-Prill. Do të ishte mirë që të ishte, do të ishte mire të ishte edhe opozita. Iku ajo e vjetër erdhi ajo e reja që erdhi. Sepse do të ngrejë kartonin atje dhe duhet të njihet me çfarë ka ndodhur këtu në Këshill mendoj unë. Ata nuk njihen dot. Po të ishin këtu, do të ishin me të qartë për procedurën, edhe për ato shqetësime që ngriti Avokati i Popullit. Do të ishte shumë mirë që të ishin sepse do të votojnë një kandidat që nuk është verifikuar plotësisht, të paktën për një pikë të ligjit. E verifikonin vetë, i ka në varësi Kuvendi ato dy organet e tjera. Meqenëse është republikë parlamentare dhe e bën këqyrjen e vet. Kështu që mendoj që Këshillit mos prezencë e dy përfaqësuesve i ka sjellë një farë problemi por që luajalitetin do ta tregojnë në Kuvendi për të patur kohë në lidhje me mënyrën se si Kuvendi do e vlerësoj por dhe Këshilli duhet ta vlerësojë....

Mimoza Arbi ndërhyr dhe shprehet se pavarësisht se nuk kanë marrë pjesë anëtarët e komisionit të ligjeve sipas ligjit ato, janë në dijeni për të gjitha materialet e plotësuar. Ata janë në dijeni dhe bëjnë diskutime në lidhje me materialet.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se ne i njoftojmë rregullisht. Komunikimin unë nuk e kam ndërprerë pavarësisht se çfarë ndodhi. Komunikimi komisionit të ligjeve i bëhet rregullisht. Çdo material që merrni ju e marrin dhe ata. Për ato që u thanë është qëndrimi juaj dhe çështje pikëpamjeje. Por verifikimin e të gjitha kushteve për Inspektorin, edhe për atë element që ju mendoni, ne e kemi bërë dhe mendojmë se e kemi bërë të plotë. I kemi kërkuar në mënyrë të shprehur informacionin nëpërmjet DSIK dhe na ka ardhur përgjigje edhe në këtë pikë me një shprehje që në raport me këtë çështje dhe referon pikën përkatëse dhe kam përshtypje se referon aktin tonë normativ, ka vendosur pikën përkatëse..... (ndërhyrje pa mikrofon), nuk ka rëndësi kjo është tani të bëjmë lojëra fjalësh, nuk ka vendosur germën e fundit, “ë” të nenit 199, por ka vendosur nenin e aktit tonë normativ sepse në nga ajo e kemi marrë, është e njëjta fjali. Kanë thënë lidhur me këtë kusht nuk ka të dhëna të kësaj natyre. Ju e keni atë qasjen që DSIK kush është, varet nga Kryeministri etj.. Këto nuk janë komente që unë dua ti elaboroj për ti kundërshtuar apo për ti pranuar. Ne i kemi kërkuar një ndihmë administrative, siç e parashikon ligji, duke pasur parasysh natyrën e klasifikuar të informacionit, mënyrën se si funksionojnë agjencitë informative. Dhe të kërkosh ndihmë administrative, në këtë rast, nuk është e paligjshme. Është ndihmë administrative, e kërkon dhe e keni të motivuar, duke pasur natyrën e informacionit, duke pasur natyrën e organeve, elementët e përpunimit etj., të cilat ato organe mendojnë dhe pretendojnë se nuk mund t'ia përcjellin dokujtudo dhe kujtudo në një mënyrë të caktuar, por përcillen në një mënyrë tjetër të caktuar dhe ne i kemi kërkuar ndihmën. Ne e

prezumojmë dhe kjo është përgjegjësia e DSIK, mund ta verifikoj dhe të bëjë si e ka për kompetencë, që të merrte informacion nga agjencitë. Dhe unë e thash dhe sot që këtë informacion ata besoj e kanë marrë, nuk ka nevojë të na e përshkruajnë si e morën, por thonë lidhur me këtë ka, për këtë tjetrin nuk ka e kështu me radhe, siç ka ndodhur edhe gjate gjithë vitit . Është e kotë ta diskutojmë dhe unë e di edhe pikëpamjen tuaj .

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe shprehet se kur është dashur nga Këshilli të arsyetohet, si institucion ne kemi sjellë dehe me shkresë për ndonjë kandidat, për pozicionin e tij në raport me ligjin . Dhe Këshilli me shumicë votash ka arsyetuar diçka tjetër. Por është vendimmarrja e Këshillit, ndërsa këtu rezulton që nuk ka informacion fare në tavolinën e Këshillit. Sepse unë deri tani nuk e kam kuptuar që SHISH apo AISM-ja të kenë kthyer përgjigje nuk të jap informacion, nëse e thotë këtë në shkresën numër date AISM refuzon të japi informacion, pas kësaj Këshilli i detyruar për këtë çështje ju drejtua për ndihme administrative DSIK . Këtë po thotë Avokati i Popullit . Nëse e kuptova gabim këtë të arsyetohet më shumë në vendimmarrje. Që të ketë një arsyetim nga Këshilli që të mos hapim debat publik nesër.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se mund ta hapuni këtë debat ju, mua nuk më prish punë, përkundrazi. Këtij institucioni i bën mire të këtë edhe aksesin e drejtpërdrejtë, por në gjetëm zgjidhje se ndryshe procesi do të rinte i bllokuar. Ne e gjetëm zgjidhjen dhe e prezumojmë që e kemi marrë informacionin. Komente të tjera për veç atyre të natyrës ligjore janë të një natyrave të tjera që nuk na takojnë ne ta konsumojmë këtu . Ne kemi kërkuar atë rrugë, të vetmen që kishim. Atë e konsumuam, mund ta ngrini dhe si problem, unë se kam fare çështje, personalisht, por ne e kemi gjetur zgjidhjen dhe informacionin e kemi marrë. Përgjegjësi kanë organet përkatës që e kanë përcjellë informacionin për çështjet e tjera. Tani për këtë 30 ditëshin si do tia bëjmë?

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se DSIK nuk të ka thënë për cilësinë e filanit dhe fëstëkut dhe ky është muhabet shumë i qartë, për me tepër ne nuk jemi as gjyqtar. Ju jeni Gjyqtar dhe nesër pasnesër keni një vlerësim më të thellë për sa i përket gjerave. Ndoshta e kuptojmë ne gabim por e kemi në shqetësimin tonë . Ne e bëmë me dije ju keni vendimmarrje më të rëndësishme dhe mund ta thoni dhe e krijoni më mirë këtë gjë, nuk ka diskutim .

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyr dhe shprehet se këtë e keni të arsyetuar në secilin vendim... .

Erinda Ballanca merr fjalën dhe vijon të shprehet se por ajo që si lexohet vendimi sot ju merrni përsipër një gjë që ju nuk keni informacion dhe nëse doni ta merrni përsipër, merreni.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se kur merr ndihmë administrative nga një institucion, patjetër që e ka marrë përsipër institucioni që jep ndihmë marrjen e informacionit.....

(diskutime pa mikrofon njëherazi)

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se unë tani po flisja për fenomenin sepse në raport e di që do ta shtjelloj, por ne e kemi arsyetuar në të gjitha vendimet.

Tani për afatin. Kemi afatin 10 ditor dhe atë 3 ditor. Afati është i shkruar në ligj dhe këtu e kemi të dyfishtë rrethin e kufizimit të veprimit tonë, praktikisht. Edhe nëse mund të gjendej një justifikim sepse nuk arrihet të arsyetosh vendimin, në momentin kur e miraton listën dhe raportin, ti e ke përfunduar procesin dhe çfarë mund të them unë tani. Sepse për arsyetimet ishte një çështje tjetër që në e kaluam me referencë më parë dhe arsyetimet e para ishin shumë të vështira deri sa përfunduan që të gjendej mënyrën se si duheshin arsyetuar. Tani që ne gjetëm mekanizmin se si të komunikojmë me njeri tjetrin, si i pasqyrojmë arsyetimet e përbashkëta se edhe kjo është një çështje më vete edhe për vitin tjetër, për të rinjtë, ne këtë radhë jemi edhe me të shpejtë për angazhimin që ka dhënë Margarita. Të gjithë e kemi pasur angazhim po në 7 veta, të përputhen 7 veta në pika të ndryshme në një arsyetim nuk është një ushtrim i lehtë. Herën e parë në e patëm problem, këtë radhë nuk e patëm këtë problem. Kështu në praktikisht e mbaruam dhe e mbyllem dhe unë them se nuk kemi asnjë mundësi të lëvizim në afate Kështu që do ti qëndrojmë formal ligjit dhe ta mbyllim këtë proces se nuk kemi se çfarë të bëjmë.

Mimoza Arbi merr fjalën dhe shprehet se atëherë mund të sqaroj që dhe ky rast mund të zgjidhet sepse e ka hapësirën në nenin 74 Kushtetutës dhe Rregullorja e Kuvendit . Edhe pse e ka të përcaktuar qartë se kur mbaron një sesion dhe kur fillojnë sesionet ku thotë se Kuvendi i zhvillon punimet në dy sesione . Sesioni i parë fillon të hënën e parë të Janarit dhe sesioni i dytë të hënën e parë të Shtatorit, por thotë që sesione të jashtëzakonshme thërriten nga Kryetari i Kuvendit dhe me kërkesën e Presidentit të Republikës ose të Kryeministrit ose të 1/5 të deputetëve. Kjo mund të realizohet me 1/5 e deputetëve . Pra ka mekanizëm zhblllokues dhe ligji dhe normal dhe kjo do të jetë mënyra se si mund të veprohet në këtë rast.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se kështu do ta vendosim? Ne brenda 3 ditëve eventalisht, nëse i miratojmë 2 vendimet sot, në datën 26 unë do të firmos përcjelljen e akteve Kuvendit.

Anëtarët e Këshillit shprehin dakordësinë me këtë veprim.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se të gjitha vendimet janë të gjitha të publikuara. Dhe këto nesër pasi ti zbardhin e tu hedhim një sy dalin në faqe. Duken aty sikur kemi publikuar vetëm lejimet, por janë të tëra po të shikoni praktiken, lista e dokumenteve është e plotë dhe janë edhe vendimet e lejimit, edhe vendimet ndalimit, edhe vendimet e tërheqjes, çdo akt i joni i marrë, janë të gjitha këtu bashkëlidhur. Me korrektimet dhe sugjerimet që u bënë unë i mbajta shënim e që ti pasqyroj në raport .

Nëse nuk kemi gjë tjetër i hedhim ne votim ? Vendimin e pare e hodhëm kemi vetëm vendimin e dytë, që numërohet 154 për miratimin e raportit për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendeve vakante të ILD.

Anëtarët e Këshillit në mënyrë unanime miratojnë edhe vendimin për miratimin e raportit për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendeve vakante të ILD.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani në përfundim të çështjeve të rendit të ditës orienton Këshillin të diskutojnë lidhur dhe me procesverbalet, janë shpërndare deri tek procesverbali përmbledhës nr.28, datat pastaj janë tjetër gjë.

Erion Roshi shtron pyetjen a janë në rend dite?

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se nuk janë çështje në rend të ditës. Dy mënyra ka. Në fakt në ligj shkruhet në mënyrë të caktuar por në Rregulloren tonë të Brendshme përcaktohet në fillim të çdo mbledhje miratohet procesverbali i mbledhjes paraardhëse. Nuk është çështje e rendit të ditës, në asnjë institucion nuk shënohet, nuk është çështje thelbi, është veprim që do të ndodhi. Për 1000 arsye që kanë të bëjnë me gjithë veprimtarinë që ndodhi gjatë këtij vitit, mënyrën si filloi, me ngarkesën që ka pasur gjatë gjithë vitit, me faktin që personeli administrativ ishte më i pakët, u shtua gradualisht dhe më pas do të shtojmë edhe faktin tjetër që edhe ky personel morri përvojën e vet sepse ishte një gjë krejt tjetër për ta për ta bërë, ka 1000 arsye të kësaj natyre, duke pasur parasysh edhe faktin tjetër që nuk mund të injorohet se ky është vërtet KED por vetë Gjykata e Lartë ka funksionuar me një mbingarkesë të jashtëzakonshme, të paktën deri në fund të korrikut dhe fillimin e shtatorit sepse kur të dalin statistikat do të shikohet se numri i vendimeve ka qenë shumë i madh për atë periudhë, megjithëse në numra ishin shumë të reduktuar, përveç ritmeve që Gjykata e Lartë i ka mbajtur dhe po i mban edhe tani qepo flasim, megjithëse ka një numër këshilltarësh më pak se 1/3 e asaj që duhet të kishte ose që ka pasur dikur, realizon

një mbinorme të çështjeve që përgatiten për relativitet, me shpresën që vitin e ardhshëm të vijë edhe gjyqtarët e tjerë për të filluar punën. Ka edhe disa probleme të tjera Gjykata e Lartë, të cilat nuk duken, sekretaria gjyqësore ka edhe ngarkesa të tjera të paparashikuara, si dokumentacioni shumë i shpeshtë që kërkohet nga organet e rivlerësimit kalimtar, KLGJ, KLP etj. Ato kërkojnë një dedikim të personelit. Edhe në pjesën e sekretarisë gjyqësore Gjykata e Lartë ka gjysmën e personelit. Një pjesë e tyre kanë qenë të dedikuara dhe për Këshillin. Për këtë arsye meqenëse kjo ka qenë dhe pjesë e imja e përgjegjësisë, tashmë edhe e plotë sepse jam i detyruar të jem në të dy funksionet, duhet të bëjë një zgjedhje, midis përdorimit të atyre burimeve që ishin për tu marrë me zbardhje procesverbalesh, pasi na rezultoi që kishin shumë punë, ju merrte kohë, apo do të merrreshin në këd me mijëra veprimet e kërkesave, informacioneve, përpunimit të tyre, ju e njihni procesin. Sigurisht prioritet do të merrte përgatitja e materialeve, jo sepse neglizhoheshin të tjerat, por kur nuk ke zgjedhje do të administrosh burimet që ke në dispozicion për më të mirën e mundshme. Dhe unë këto zgjedhje kam bërë. Munda ta them kudo. Këto ishin mundësitë. Ndërkohë, sidomos në 2 muajt e fundit, jo thjesht për faktin se kam ngelur i vetëm dhe kam edhe drejtimin e gjykatës, sigurisht mund të administroj edhe drejtpërdrejt burimet e Gjykatës së Lartë, por edhe për faktin se ka qenë më e lehtëuar ngarkesa e Gjykatës së Lartë, për zbardhjen e procesverbaleve kemi përdorur dhe persona të tjerë që nuk janë ndërmjet tre sekretareve që kishte Këshilli dhe po ia dalin. Edhe kjo ka vështirësitë e veta sepse njerëz që nuk janë në sallë, e kanë edhe më të vështirë për të identifikuar anëtarët, duken probleme të vogla por janë gjëra që janë zgjidhur. Pasi e zbardhin e shikojnë sekretaret për këtë qëllim. Mendoj se do të jetë problem edhe për vitin tjetër, por duke qenë se duhet të jem në këtë Këshill dhe se e kam këtë detyrë, edhe pse ngarkesa do të jetë më e vogël pa diskutim krahasuar me këtë vit, duhet të theksoj se numri i personelit nuk është i mjaftueshëm. Ai që duhet të jetë i dedikuar KED , edhe në sallë e mbledhjes duhet të jetë më i madh, aq më tepër që mbledhjet tona janë të gjata, nuk mundet me burimet aktuale të zbardhen procesverbalet.

Për këto arsye ka ardhur e gjithë kjo problematikë. Po e përjashtoj këtu edhe problemin tjetër që duhet bërë përmbledhja e procesverbaleve, Kjo është një punë tjetër sepse dikush duhet ta lexojë dhe duhet të përmbledhë sepse diskutimet tona me mendimet e shfaqura tona, për shkak të ligjit dhe jo për shkak të zgjedhjes sime, nuk duhet të dalin. Mbas unë i pari përgjegjësi dhe e kam të drejtpërdrejtë. Duhet të dalin të përmbledhura dhe vetëm qëndrimet dhe e plotë vendimmarrja. Duhet hedhur qëndrimet në atë mënyrë që të mos dalin diskutimet e një anëtari. Është një mënyrë pak delikate e të shkruarit aq sa e kam përvojën në këtë kohë. Është një gjë jo e lehtë. Jam i detyruar që ta lexoj me kujdes gjithë debatin e

kolegëve për të përmbledhur se kush ka qenë qëndrimi aty ku ka, për të mos lënë vend të kuptohet si diskutimi. Kështu ndodh sa kohë është e shkruar ashtu dispozita.

Procesverbalin e parë e kemi publikuar të plotë, ishte zgjedhja jonë, ishte mbledhja kostituive. Ndërsa për pjesën tuaj të procesverbalit të përmbledhur, kujtoj që tek ai me nr. 2 dhe 3 jam përpjekur të bëj përmbledhje. Z. Bledar më është përgjigjur që të nesërmen. Nuk kisha mendimin e Avokatit të Popullit për pjesën e vet të përmbledhur. Por meqenëse qasja më vonë nga ato me nr.4, 5 e prapa është që e ta vendos të plotë diskutimin tuaj, këtë do ta bëjmë edhe tek procesverbalet nr. 2 dhe 3 duke hequr të përmbledhurën dhe të vendoset teksti i plote. Ka pasur një problem të vogël në rastin tuaj si jo anëtarë, jo në rastin tonë, ka ndodhur jo aq shpesh por ka procesverbale ku vërtet që ai që e përmbledh duhet të jetë i kujdesshëm. Ne duhet të ndjekim radhën në diskutim, diskutojnë anëtarët, pastaj ndërhyjnë por na rrëmben debati, ka ndërhyrje. Dhe në debat ka dy gjëra ose hidhen mendime apo reagime të momentit për çështjen por që nuk e zgjidhin në tërësi atë, ose nganjëherë fliten 2, 3 fjali e që praktikisht janë një lloj qëndrimi. Të shkruash në një procesverbal që diskutuan anëtarët, avokati i popullit parashtrori se , përfaqësuesi i Presidentit parashtrori se dhe pastaj po bëhet një debat, del një procesverbal i çuditshëm. Në këto raste kam lënë fjalën e plotë por i kam grupuar d.m.th. çfarë po diskutonte Këshilli, kush ishin qëndrimet tuaja në këtë debat dhe në fund qëndrimin përfundimtar apo vendimmarrjen e Këshillit. Ka pasur jo pak raste që na ka ndodhur kjo gjë dhe për përmbledhësin e procesverbalit kjo është një vështirësi shumë e madhe, por ndoshta punës i ka bërë mirë. Radha e diskutimit disiplinon ca gjëra, por mund të kufizojë disi komunikimin dhe parashtrimin e problemeve, reagimet e duhura dhe në kohën e duhur. Këtë doja që ta parashtroja shkurtimisht. Mund të them që përveç ççarë është transkriptuar unë kam vendosur dhe kufjet në vesh, aq më tepër kur flasim me ose pa mikrofon, kur ndodh që nevojitet të verifikojë jo vetëm saktësinë e fjalëve të mia por edhe të tjerëve, për tu kujdesur që të mos humbasin arsyetimet e dikujt. Ka pasur raste që është harruar fjale apo shprehje, apo është dëgjuar keq etj. Kjo është ajo që ka ndodhur. Të tjerat janë në fazën e fundit për tu shpërndarë dhe po punohen njëkohësisht.

Ka pasur një komunikim me shkrim edhe nga znj. Erinda për këtë çështje që më kërkon regjistrimet audio dh transkriptet, e ka kërkuar edhe më përpara. Unë e kam thënë në mbledhje që mund ta dëgjoni këtu por kopje nuk mund tu jap. Ditën e sotme ka ardhur edhe nga Institucioni i Presidentit të republikës një shkresë ku kërkohet e njëjta gjë. Unë në cilësinë time si kryetar kam kthyer përgjigje se për përgjegjësinë ligjore që kam, nuk mund të nxjerrë jashtë zyrës së KED materiale audio dhe transkriptime të plota. Ato mund të dëgjojen

vetëm në zyrën e KED dhe kam dhënë edhe arsyetimin tim përkatës. Për sa kohë që ligji është formuluar në këtë mënyrë.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se në lidhje me këtë çështje kam pritur të diskutonim menjëherë në muajin e dytë ose të tretë. Këto pyetje unë i kam shtruar, nuk me keni kthyer përgjigje, u kam bërë kërkesë me shkrim dhe më parë por nuk me keni kthyer përgjigje. Sot thoni nuk i nxjerr materialet audio nga zyra e KED. Nuk e di mbi çfare baze ligjore ju kufizoni kompetencën e Avokatit të Popullit të parashikuar në Kushtetutë dhe në ligj për të marrë pjesë në veprimtarinë dhe mbledhjet e Këshillit. Ky është një qëndrim tërësisht i paargumentuar në gjykimin tim, por nga ana tjetër nuk shkon as në frymën e ligjit. Sot po diskutohet që p-v që do të bëhen publike, ne do ti bëjmë publike sot dhe unë duhet të marr përsipër miratimin ose jo të një gjëje që kam thënë para 8 muajve, pa e verifikuar se si e kam thënë, nuk mund ta them me mendjen e sotme sepse qëndrimet e secilit prej nesh evoluojnë. I bie që unë sot të marr përsipër të them diçka, të rikujtoj a e kam thënë tamam kështu apo jo për diçka që kam thënë para 8 muajsh, pa qenë i qartë në lidhje me p-v, nëse do ta kishim të plotë, i cili nuk është miratuar në asnjë mbledhje të Këshillit.....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyr dhe shprehet se në mbledhje miratohet procesverbali i përmbledhur, kështu thotë ligji.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe vijon të shprehet se ligji nuk thotë kështu. Sapo e lexova, ta lexojmë edhe njëherë të gjithë bashkë. Ka dy dispozita të posaçme, neni 226/d siguron që mbledhja e Këshillit të regjistrohet në sistemin audio dhe që një përmbledhje e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit, të mbahet dhe të bëhet publike në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë. Më poshtë përcakton një procedure ballafaqimi, për hir të së vërtetës vetëm për anëtarët. Më pas “siguron dokumentimin e mbledhjes së Këshillit dhe mbajtjen e dokumentacionit. Duhet dokumentuar çfarë është bërë. N.q.s. unë jam pjesëmarrëse në mbledhje dhe nuk ka asnjë vendimmarrje të mendimeve të shprehura lidhur me kandidatët, se ka pasur dhe një vendimmarrje në gjykimin tim në këtë mbledhje për Rregullore, si mbaj mend unë, që p-v do të ishin të plota për çdo gjë që nuk kishte të bënte me procedurën verifikimit të kandidatëve, se do të kishte emra konkrete dhe ky ka qenë qëllimi, por jo p-v që kishin të bënim me mbledhjet e miratimit të rregulloreve. E kam kërkuar pikërisht për këtë gjë. Unë mbaj mend që është vendosur kjo çështje në Këshill që duhet të kishim p-v të plotë për pjesën që nuk cenonte identitetin e individëve apo përzgjedhjen e një individi të caktuar dhe ju as këtë nuk ma kini vënë në dispozicion. Mbledhje të cilat unë kam qenë prezente nuk ka njëri në botë që të thotë nuk ti jap hajde dëgjoje këtu, ku e kini kompetencën të mos ma jepni....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se mund ta dëgjoni këtu, nuk mund të dalë jashtë zyrave të KED.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe vijon të shprehet se për çfarë arsye? Nuk e kuptoj. Ne jemi pjesëmarrës këtu. Nuk ka asnjë arsye, nuk janë publike është gjë tjetër, informacion publik është gjë tjetër, unë kam detyrimin si gjithë ju që ta kem, është informacion publik, ajo që bëhet publike është përmbledhja, është tjetër gjë, dhe gjithë transkripti është gjë tjetër. Përveç faktit që ne ato mbledhje që nuk ka diskutim, ju e sqaruat zoti kryetar se cilat janë ato gjëra ku ju nuk do të jeni fare në publik, ku nuk do të jemi dhe ne. E kini mbajtur këtë qëndrim, keni mendimin tuaj. Por kemi thënë se dhoma e këshillimit është një gjë ku nuk ka asnjë njeri, nuk dimë se çfarë është bërë, e dini vetëm ju që jeni anëtarë. Po këto vendimet e tjera që janë jashtë vendimmarrjes e që nuk kanë të bëjnë me individë të caktuar? Po ato që kanë qene ne lidhe me Rregulloren, që bërja e rregullore është një aktivitet tërësisht që s`mund të konsiderohet në kuptimet e parashikimeve që ju keni përcaktuar në çështjen e shkeljeve disiplinore. Pavarësisht se çfarë thoni, e vërteta është që e kini zgjeruar në ekstrem mungesën e transparencës. Qëndrime që ju thoni që nuk duhet të jenë fare në këtë rregullore...

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se d.m.th, unë u jap juve të këshilloni procesverbalin edhe pse ligji nuk e parashikon këtë detyrim dhe ju thoni unë jam në ekstrem? Ligji parashikon që procesverbali i përmbledhur konsultohet vetëm me anëtarët. Kjo ekstrem quhet?

Erinda Ballanca merr fjalën dhe vijon të shprehet se në qoftë se anëtarët kanë rënë dakord dhe anëtarët mund të marrin përsipër gjërat të cilat nuk janë thënë në mbledhje, n.q.s e bëjnë ok. Por unë i kam parë procesverbalet, aty nuk ka asnjë germë të asnjë anëtar. Asnjë nga kandidatët nuk mund të thotë gjë sepse nuk ka thënë asgjë. Asnjë nga anëtarët nuk referohet në p-v në asnjë germë. Nuk ka asnjë zë nga anëtarët. Kështu që për çfarë arsye po të ishte ky p-v në këtë formë që ju mendoni, legjislatori do të kishte shënuar që kanë të drejtë anëtarët që të ballafaqojnë qëndrimet? N.q.s. p-v ishte kaq i përmbledhur dhe nuk thoshte asgjë atëherë për çfarë arsye do të ishte parashikuar kjo klauzola, që anëtarët të verifikojnë fjalët e mia? Asnjë nuk ka interes, nuk po ndodh. Nuk ka asnjë nga anëtarët interes se çfarë kam thënë unë në ato mbledhje. Se besoj që ju ia kini dërguar anëtarëve dhe ata ja u kanë miratuar p-v, mendoj unë. Unë i kam lexuar dhe ato p-v realisht nuk thonë asnjë gjë, është njësoj si njoftim, praktikisht është njoftim për shtyp plus qëndrimi i Avokatit të Popullit dhe qëndrimi i përfaqësuesit të Presidentit dhe përfaqësuesit të Kuvendit, nuk ka asnjë fjalë tjetër, të asnjë çështje, as nën çështje, as parimore, që të thuhet që Këshilli vendosi të trajtoje për

shqyrtim këto 5 çështje, me shumicë u vendos kjo. Ju thoni në të gjitha rastet që Këshilli miratoi rregulloren me ndryshimet përkatëse. Nuk e di nëse keni të tjera por janë mbledhje 6 orëshe janë në dy faqe...

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet që mos e thjeshtoni kaq shumë. Këto janë të gjitha. Këto probleme i kemi diskutuar në janar dhe në shkurt. Mund të ishte ndërmarrë një nismë ligjvënëse, të ishte ndryshuar dispozita dhe kjo do të ishte histori e mbyllur kjo sot. Tani ne nuk mundet, e kemi bërë këtë debat. Aty në ligj ka dy klauzola një proces-verbal i përmbledhur dhe një ndalim që të bëhet publik diskutimi. Atëherë si ta respektoj ndalimin nëse e vë emrin e anëtarit dhe atë çfarë ka diskutuar?

Erinda Ballanca merr fjalën dhe vijon të shprehet se atëherë, në themi qëndrimet e mbajtura kanë një kuptim për çfarë janë, sepse nëse këtu atëherë do të ishte e vërtetë kjo, ka ndonjë një dispozitë këtu që thotë se që përpara nëse një anëtar ka dyshime për saktësinë e përmbledhjes, përmbajtjes së p-verbalit, për çfarë, nuk ka fare as votë as qëndrim. Nuk ka fare, në p-v nuk ka çështje fare. Nëse do bëni publike të tjera p-v atëherë është tjetër gjë. Unë i kam lexuar procesverbalet....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se në p-v ka çështjet, qëndrimet dhe votat. Patjetër që i ka kudo. Procesverbalet u janë dërguar dhe nuk mund të trajtohet një gjë dhe të të çoj ty një gjë tjetër. Atë që kam dërguar ajo është. Kur të bëhen publike këtë do ta shohësh. Mos ta trajtojmë njëri-tjetrin si delinkuentë. Jam serioz për atë që dërgoj dhe ajo është. Të thashë që në p-v e përmbledhur nr.2 dhe 3 janë në version përmbledhje të fjalës tuaj, do ta lëviz dhe do ta vë fjalën e plotë. Ta thashë vetë këtu. Por unë nuk jam njeri që ndryshoj tekste.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe vijon të shprehet se personalisht kryetar e kam të pamundur, përveçse të bëj falsifikim, e vetmja mënyrë që të them jam ok me p-v, është që të falsifikoj atë që mund të kem thënë atëherë. Nuk e mbaj mend. Nuk kam asnjë mundësi që të kujtoj ekzaktësisht se çfarë kam thënë para 8 muajve, sepse të gjithë ndryshojmë qëndrimet. Këtu ka pasur anëtarë që kanë ndryshuar qëndrimet, kanë mbajtur qëndrime të ndryshme. Sepse secili prej ne evolon. Ajo që mund të them sot mund të mos ketë qenë e njëjta që kam thënë në atë kohë, sepse kam kuptuar arsyetimin, kam kuptuar qëndrimin e kolegeve, kam parë sa i rëndësishëm është p.sh.. fakti i funksionalitetit të organit, që ne duhet të japim ILD të themi publikut, edhe pavarësisht se disa nga këto mund të mos e kishin plotësuar një kriter, gjithsesi e kam konsideruar që duhet bërë gjithsesi p.sh. Secili prej nesh ndryshon qëndrimet që kemi pasur kanë qenë më strikte ose kanë qenë të ndryshme. E kam këtë gjë tërësisht të pamundur që ta bëj. Nuk ka se si mund të thoni që nuk e nxjerr që këtej. Ju e kini vetë

përgjegjësinë e bëni si të doni. Unë jam duke thënë, siç kam të drejtën që në një afat të shkurtër kohor të kujtoj çfarë kam thënë dhe kam detyrimin që të them çfarë kam thënë, ju e keni bërë me shume qetësi, ju keni vënë afat vetëm për ne 48 orë. Ju e keni bërë me qetësi nuk keni vënë afat për veten. Unë se kam menduar kurrë që do e trajtonit, sekretaret tuaja të zbardhnin mendimin në mënyrë të ndryshme nga qëndrimet tona. E vërteta është që kështu e keni zbardhur, aftësi juaj e jashtëzakonshme. Pra nuk kemi vënë afat sa kohë keni ju për të bërë p-v, keni vënë afat që ne duhet të shohim për 48 orë. Ndërsa ju vetes tuaj nuk i keni vënë afat. Mendohet që p-v miratohet mbledhjen e ardhshme, pas dy mbledhje të ardhme të paktën, por ska zot none që të mendojë se p-v miratohen pas 10 muajsh. Nuk e bëj dot këtë. Prandaj ju kam thënë në të gjitha rastet që jam e gatshme gjithsesi, për atë problematika që unë kam, ashtu siç ju kam pyetur për dy tre problematika që kam pasur, ua kam thënë se kam dyshimet e mia, nuk dua të dal e të bëj, kam mendimin tim që si e mbaja mend unë ishte vendosur ndryshe, është mbajtur ndryshe. Mund ta kem gabim, më është bërë e pamundur që ta verifikoj këtë gjë. Tani secili e di vetë. Ky është qëndrimi im. Shpresoj që do të jetë publike kjo përmbledhja e p-v. Më shumë se kaq nuk kam fare bëj. Kush e ka mundësinë që të mbajë mend fjalët e veta siç i ka thënë para 10 muajsh është ok, unë nuk i mbaj mend.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se në këto që thotë Avokati i Popullit për të mbajtur mend është e vërtetë se tani ka kaluar një kohë. Unë them të diskutojmë njëherë nëse mund të japim kopje apo jo të p-v a të regjistrimeve të paktën për pjesën ku janë pjesa e akteve normative, jo diskutimi i emrave konkrete. Meqenëse është kërkuar, ta diskutojmë këtë moment, për aktet normative dhe jo vendimmarrje për emra konkret. Të diskutojmë mund ta japim apo jo kopje të regjistrimeve. Përmbledhja është tjetër gjë. Ju jini treguar transparent, e keni thënë hapur çfarë qëndrimi kemi por duke qenë se po na bëhet prezent si Këshilli duket sikur ne nuk po reagojmë, nuk kemi asnjë vendimmarrje, nëse ne jemi dakord të miratojmë qëndrimin tuaj.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe shprehet se faktikisht duhet të ndajmë pak se duket sikur kjo po shtrohet si diskutim në Këshill, por me sa parashtrori kryetari kjo çështje ka marrë fund që nuk do jetë. N.q.s. është kthyer një përgjigje për Institucionin e Presidentit apo dhe Avokatin e Popullit...

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani përgjigjet se e keni marrë përgjigjen. E kemi dërguar me kohë me korrier.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe vijon të shprehet se nuk e di, në qoftë se është nënshkruar një përgjigje për Institucionin e Presidentit të republikës që nuk të takon ta marrësh, nuk mendoj që çfarë të diskutojmë në Këshill. Ka një përgjigje pavarësisht se nuk

jemi dakord me këtë qëndrim, për arsye se si pjesëmarrës këtu në Këshill nuk mund të kufizohem të dëgjoj apo të regjistroj memorien time aq sa mbaj mend se çfarë flitet, për objektin, kundërshtimet, debatet. Fjalën time e mbaj mend mire për aq sa në kohë fizike mund ta riprodhoj edhe njëherë në të njëjtën mënyrë. Ndërkohë që sot trajtohem si publik. Nuk të takon se mbledhjet janë sekrete. Ndërkohë që në këto mbledhje çfarë sekretit kam për institucionin që përfaqësoj kur isha këtu. Për këtë nuk jam dakord, me këtë përgjigje që na është dhënë. Diskutimi i këshillit tashmë është vetëm formal. N.q.s. do e shtrojë Këshilli dhe do të marrë një vendim tjetër nga ajo që ka vendosur kryetari, mirë do të ishte. Por fakti është po të shikojmë dispozitat ligjore në harmoni me Rregulloren le të jemi siç e thotë ligji, p-v dhe përmbledhje. P-v thotë ligji dokumentim, përmbledhje thotë rregullorja. Por që të dalë një përmbledhje duhet të ekzistojë fizikisht i tërë procesverbal, siç behet, dhe në funksione kemi kryer në organet kolegjiale, në KLD apo organe me borde ku kemi funksionuar, dihet që aty zbardhet edhe një “e”, çdo gjë. Përmbledhja për tu bërë publike është tjetër gjë. Kjo vjen e dyta në radhë. Kështu që sipas të dy dispozitave, ligj dhe rregullore, i binte që secila nga përmbledhjet që derivonte nga origjinali, të miratohej në mbledhjen tjetër. Kjo gjë nuk është bërë, arsyet kryetari i përmendi, por që është fakt që kanë kaluar 12 muaj, edhe unë që përfaqësoj Presidentin nuk kam mundësi që të riprodhoj fjalët e mia apo të mendoj debatin që kam pasur me ndonjë nga të ftuarit e tjerë, shkëmbime opinionesh juridike me një nga anëtarët. E kam bërë në dy raste, në fund të muajit maj dhe fillim qershor, për të qenë korrekt ato i mbaj mend, i lexova para 2 ditësh në email, fjala me dukej korrekte, që flisnin për mbledhjet e muajit janar shkurt për rregulloret. Tashmë në muajin dhjetor mua më duket e pamundur, pa parë njëherë p-v e madh, këtë kemi kërkuar, të printuar p-v e madh, të zbardhur edhe audion. Nuk besoj që është sekretuar audio për një të ftuar prezent këtu. Megjithatë është vlerësim i Këshillit, por që besoj që Këshilli nuk do marrë vendim sot. Me sa mbaj mend nga hera e kaluar do bëhej një mbledhje. Por kur na vjen një përgjigje e tillë duhet të pozicionohemi e të punojmë letrat që kemi ose në format që na erdhi. Do të duhet të mbajmë edhe në qëndrim në lidhje me këtë çështje, qëndrim mbi miratim e p-v, qëndrimin mbi procesin e kemi mbajtur në dy aspekte edhe në Këshill dhe një proces tjetër që e ka nisur vetë Presidenti. Kështu që nuk di ç’është them në këtë situatë. Ajo që duhej të ishte pranuar nuk është bërë, ajo që ne prisnim të bëhej nuk u plotësua, jo vetëm për Avokatin e Popullit por dhe Presidentin që e ka me Kushtetutë që kërkon të dhëna me shkrim nga institucionet dhe ta kufizosh në marrjen e këtyre të dhënave kur ka qenë vetë këtu, nuk më duket një vendim i drejtë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se jo kështu e mendoni por unë kam një klauzole shumë të fortë aty dhe kjo është përgjegjësi ime direkte, edhe nëse znj.Margarita, siç mundet ta mendoja edhe unë individualisht, të mendojë që mund të jepet diskutimi im, unë kam përgjegjësi direkte. Unë do ti qëndroj linjës deri në fund. Për sa kohë ligji më ngarkon, sidomos mua që nëse bëj publik diskutimin tim apo të një anëtari kam përgjegjësi disiplinore. Unë e kam të dyfishtë. Ia kam shkruar Presidentit do ta shkruaj edhe Avokatit të Popullit me shkrim. Kam edhe një përgjegjësi tjetër më të madhe se disiplinore. Unë duhet të siguroj dhe të dokumentoj gjithshka dhe duhet të marr masa që te përpilohet një p-v i përmbledhur, që të shqyrtohet dhe ky të bëhet publik dhe n.q.s. më del aty brenda që unë pa dashje, se qëllimisht nuk e bëj, nxjerr diskutimin dhe qëndrimin e një anëtari unë mbaj përgjegjësi dhe nesër, se kështu është Shqipëria, dikush tjetër mund të thotë po kjo nga doli, kush e ka përgjegjësinë. Unë e kam, nuk e kanë sekretaret, ato bëjnë transkriptin. Për mua kjo është lodhje shumë madhe të përmbledh një proces verbal dhe ai e tha ta dëgjoj sa kohë duhet, po mua sa kohë më duhet që ta përmbledh, madje ta dëgjoj se ndonjëherë nuk bindem sidomos për fjalët tuaja që të jetë çdo gjë e hedhur. Kjo do kohën e vet. Ligji këtë parashikim ka, më ngarkon me përgjegjësi. Nëse dalin audiot dhe transkriptet jashtë godine, kush e ka përgjegjësinë? Nuk e kanë anëtarët e kam unë përgjegjësinë. E vërtetë ajo që thotë Bledi dhe unë e mendoj gjithë ditën, unë jam në mbledhje, e dëgjoj dhe nuk kam të drejtë ta marr atë që dëgjoj, sepse kështu janë rregullat. Unë nuk kam garanci, sikurse dhe tek unë nuk ka njeri besim që e kam kryer detyrën deri në fund, edhe unë nuk kam pse të kem besim tek askurrkush që po ti jap materialin audio dhe transkriptin nuk do ta bej publik këtë gjë. Unë jam i detyruar që ti ruaj këtu. Për ti dëgjuar mund ti dëgjoni këtu. Jashtë zyrës së KED nuk del. Ka një organ që e merr që është prokuroria, por kjo është një çështje krejt tjetër, sepse nuk kam autoritet dhe aty jam i detyruar dhe jam i urdhëruar për ta dorëzuar. Por askurrkujt tjetër nuk mund ti jap materiale jashtë kësaj godine audio dhe transkripte, jo se kjo me vjen përshtat sepse edhe unë do të doja që fjalët që kam diskutuar të jenë publike, të jini shumë të sigurtë për këtë sepse nuk kam humbur kohën kot këtu, për të dalë anonim. Por unë kam një parashikim ligjor. Ju mund të kishit ndërmarrë nisma dhe të ishte ndryshuar kjo gjë, le të bëhej publike, le të bëhej mbledhja e hapur sepse nuk ka asnjë problem, nuk po bëhet gjë e veçantë këtu që nuk ndodh askund tjetër. Mua më duket se edhe ata që i kanë mbledhjet e hapura kam përshtypjes se janë më pak transparent. Sepse ka gjera të tjera që nuk i keni parë në organ tjetër, i shikoni tek ne, nuk i kërkon ligji, këtë ne i bëjmë vetë, edhe vendimet e arsyetuara në detaj i bëjmë ne, edhe aty ku nuk e kërkon ligji. Nuk kemi qasjen për të qenë të mbyllur, por ka disa shtrëngime ligjore, jemi juriste jemi në të njëjtin profesion dhe mua nuk

më garanton kurrkush që dalja e materialeve jashtë zyrës nuk do të përbënte shkelje të ligjit për mua. Juve mund të kishit përgjegjësi ose jo, kjo është një çështje që nuk e zgjidh sepse nuk kam autoritet. Por jam i detyruar të parandaloj një gjë që mund të ndodhi. Unë nuk mendoj që do ta bëni ju që jeni këtu, nuk kam arsye ta mendoj, por formalisht duhet ta kem arsye këtë gjë. Edhe për procesverbalet e përmbledhur unë ua dërgoj, e kemi vendosur në rregullore ndonëse nuk e ka parashikuar ligji.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se ne nuk kemi asnjë mundësi të konfirmojmë ato që kemi thënë para 10 muajsh. Në asnjë mënyrë dhe një rast, vlera dhe rëndësia e dokumentimit dhe e dhënies të kësaj të përmbledhurit është i përcaktuar qartë, ka një kohë të caktuar, kontekst të caktuar në të cilin duhet të paraqiten. Transparenca e këtij organi është xha shumë e cunguar për shkak të ligjit, nuk është vullneti juaj. Por e keni bërë dhe me shumë me vendimmarrje të caktuara, e keni bërë edhe më pak transparent. Kështu që nuk ka si të predikoni e të na thoni që ne kemi transparencë të madhe kur e vërteta është që me veprime konkrete

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyr dhe shprehet se unë jam jurist, jam gjyqtar, nuk i bëj predikime kurrkujt, çfarë mendoj unë është problemi im, nuk mbaj fjalime, unë zbatoj formalisht atë që është e shkruar dhe miratuar. Mund të mos përputhet me mendimin tim por çfarë rëndësie ka kjo. Do të zbatoj atë që është miratuar....

Erinda Ballanca ndërhyr dhe shprehet se ju kur ju intereson thoni rregullorja , kur ju intereson ligji, kjo është çështja. Kjo është e qartë unë po them dua të më siguroni pjesëmarrje në veprimtari të Këshillit siç e thotë Kushtetuta dhe ligji, n.q.s e mendoni ndryshe zgjidheni si të doni. Ju kini përgjegjësi të më jepni mua garanci të më garantoni të më jepni mundësinë që të kem pjesëmarrjen në veprimtarinë e KED....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyr dhe shprehet se nuk më intereson asgjë. Zbatoj vetëm ligjin. Dhe përgjegjësitë i kam unë. Nuk më jepni dot ju garanci mua. Shkoni kërkoni atë që është sekret hetimor tek prokurori, shko ta kërkosh. Do ta marrësh dot? Nuk ta jep dhe kjo nuk ka lidhje me Kushtetutën. Kur një gjë është e ndaluar të bëhet publike, është e tillë dhe nuk dua të hyj në detaje.

Erinda Ballanca ndërhyr dhe shprehet se unë nuk jam publiku. Po u them edhe njëherë, që ju keni përgjegjësinë që të më siguroni pjesëmarrjen në mbledhje dhe veprimtari. Mund të më thoni mua se çfarë është kjo përtej kësaj procedure. A ma keni garantuar apo jo këtë të drejtë që ma ka dhënë Kushtetuta dhe ligji.....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyr dhe shprehet se unë them që këtë që ta kam garantuar. Ju mendoni ndryshe kjo është një tjetër problem.....

Erinda Ballanca ndërhyt dhe shprehet se nuk më keni garantuar të marr pjesë në asnjë veprimtari tjetër përveçse pjesëmarrjes në mbledhje pjesërisht. Keni bërë dhe shumë veprimtari të tjera që në gjykimin tim unë nuk kam qenë e përfshirë. Kjo është vendimmarrja juaj nuk ka rëndësi. Ajo që unë po them në rastin konkret ka të bëjë me një të drejtë që kam se nuk jam publik i përgjithshëm. Publiku i përgjithshëm ka për të marrë informacion që ka thënë ligji. Nuk jam publik këtu....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se kemi koncepte krejt të kundërta në këtë gjë. Kërkoni në SHISH tu jap dokumente sekrete, ua jep dhe që ju ti bëni publike, kur i ndalohet tua japë? Nëse e mendoni, merrni nisma për të ndryshuar situatën, mund të shkoni në Kuvend, por më drejtoheni mua e më kërkoni të kapërcej ligjin të nxjerr audiot dhe transkriptet nëpër institucione. Nuk i nxjerr nga godina, asnjëherë. Unë nuk kapërcej ligjin.....

Erinda Ballanca ndërhyt dhe shprehet se ju të zbatoni ligjin. Kjo nuk është fare koncept i ligjit për personat që janë në mbledhje. Ata janë pjesëmarrës....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se zyra e KED është këtu dhe jo në zyrën tuaj, veprimtaritë bëhen këtu dhe asgjë nuk del nga kjo godinë....

Erinda Ballanca ndërhyt dhe shprehet se ky është konflikt institucional që kemi. Është e qartë, ju thoni që kjo është gjithçka që duhet të jetë se është e juaja, e kuptoj që është e juaja, por them që nuk është e juaja, sepse ju nuk jini gjithçka. Keni edhe ju kompetencat tuaja të kufizuara, siç keni detyrimin për ti botuar edhe proces verbalet, edhe transkriptimet për ti mbajtur dhe për tu dokumentuar gjithë veprimtarinë e institucionit. Kjo është përgjegjësi e juaja. Nuk e bëni dot. Mund të bëni dorëheqjen....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se nuk dorëhiqem edhe sepse jam i detyruar të bëj këtë funksion. Të jeni e qetë për këtë nuk dorëhiqem se duhet të bëj detyrën. Kjo është detyrë dhe nuk heq dorë nga detyrat....

Erinda Ballanca ndërhyt dhe shprehet se detyra ime është që të garantoj që nuk vendoset p-v nga sekretarja e radhës por është ai që është i sakti dhe përfundimtari. E kam ngritur këtë problem vazhdimisht, fjalët e mia i kam të pamundur që ti verifikoj dot për 48 orë apo për një javë ndërsa ju thoni e kam të pamundur ti zbardh për 10 muaj.....Sikur ne nuk kemi asnjë punë tjetër. Nuk është vetëm kjo punë mandati im....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se të jemi seriozë. Ky Këshill me 6 veta personel gjithsej, me 3 sekretare, nuk mund të bëjë veprimtarinë që bën KPK-ja dhe ne bëjmë 80% veprimtarisë që bëjnë edhe ata dhe duhet ta keni parasysh këtë e

ju e dini shumë mirë. Ndaj e thashë në fillim në mënyrë të thjeshtë dhe të përmbledhur sepse ju jeni këtu dhe nuk kam se çfarë t'ju shpjegoj më gjatë.....

Erinda Ballanca ndërhyt dhe shprehet se ju mund ta zgjidhni këtë problem. Nëse nuk e zbatoni detyrën tuaj, qartësisht mund të thoni që e kam të pamundur të zbatoj detyrën me këto kushte që kam. Pse nuk kërkuat të ndryshohet ligji?....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se prandaj jeni ju këtu prezent. Nuk jeni këtu për të marrë vendimet që duhet ti marr unë. Jeni për të marrë mendimet dhe ti përcillni aty ku duhet sepse unë nuk bëj politikë. Unë kam detyrë tjetër, unë jam zbatues i ligjit. Ju mendoni, që të kishim bërë procesverbalet por ama nuk do të çonim kandidaturat dhe do të ishim në rregull me transparencën, por nuk do të bënim përpunimin e informacionit. Me 6 veta nuk bëhet kjo. Është një situatë dhe nuk mund ti kthehem diskutimeve të hershme. Është një gjë e pazakonte, ishte e paparashikuar. Dizenjimi i normës dhe i këtij organi nuk ka qenë për të bërë këtë që bëri sivjet. Kjo gjë ndodhi dhe është e pazakontë. Sepse edhe Gjykata e Lartë nuk është ajo që mendohej në 2016. Është e reduktuar në personel, nuk ka mjete, nuk ka burime. Por unë jam i detyruar të bëj detyrën dhe mbi të gjitha jam i detyruar të bëj verifikimin e kandidaturave. Nuk kam asnjë motiv, por jam i bindur edhe anëtarët që të mos bëjmë publik procesverbalet. Për çfarë arsye?! A mund të më gjeni ndonjë motiv. Ne vendimet i kemi të arsyetuara për lejimin apo ndalimin e kandidimit. Ne i kemi thënë të gjitha. Çfarë do të mbaj unë të fshehtë?...

Erinda Ballanca ndërhyt dhe shprehet se ju jepni vendimin me arsyetim dhe nuk na jepni ne p-v sepse nuk bëhen publike....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani vijon duke u shprehur se nuk më lejon ligji. Debatin nuk mund ta publikoj. Por nuk të më thoni që e gjithë puna e Këshillit është të hartojë procesverbale, kur po mbushen dhoma me dokumente që kanë hyrë e dalë nga kjo godinë. Është një punë që është bërë me pak njerëz dhe me kolege që rraskapiten të vijnë këtu, të shkojnë në zyrë. Si mendoni se punohet?...

Erinda Ballanca ndërhyt dhe shprehet se kush është duke punuar më pak. Ne i shikojmë dokumentet në afate shumë të shkurtra, ju i shikoni më me qetësi.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani vijon duke u shprehur se kjo nuk ka asnjë lidhje me ju. Kërkoni një gjë që nuk kemi pasur burimet që ta bëjmë. E them me përgjegjësi të lartë dhe do ta them kudo nuk i kam burimet dhe nuk i kam pasur. Nuk mund të bëjë një gjë kur nuk i kam pasur burimet. Edhe tani janë shpëputur njerëzit, kanë lënë disa gjera për të bërë këto verbale dhe për këtë po shfrytëzoj autoritetin tim që ta mbyll këtë proces. Për vitin tjetër do të kem prapë probleme por për buxhetimin do të ngre zërin dhe besoj do ta marr, do ti

dyfishoj njerëzit sepse nuk mundet ta bëjnë. Është e pamundur. Gjykata e Lartë ka gjithsej 7 sekretare, nuk ka 17 dhe 3 janë këtu. Do të marrim të tjerë. E kuptoni që duhet të punojë edhe Gjykata e Lartë? Po bëjmë një program vitin tjetër se si do të zgjidhet ky problem.

Erinda Ballanca ndërhyr dhe shprehet se kush ju keni qenë më shumë se sa unë pjesë e bërjes së këtij ligji. Kështu që po ta kishit menduar më mirë nuk do të ishte ky problem. Prandaj është Kuvendi këtu që ta rregullojë dhe duhet të ishte këtu gjithmonë.....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani vijon duke u shprehur se nuk jam unë ligjvënësi dhe nuk është roman ai ligj e nuk jam unë autor i ligjit që më drejtohesh. Ndryshoni ligjin dhe të gjitha i bëjmë publike automatikisht, për 2 orë dalin në faqe. Do të ndjehem shumë mirë. Nuk kemi asnjë motiv sepse po ta kishim kjo do të kuptohej.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe shprehet se nuk e ka znj. Ballanca besoj në atë sens. Fakti është fakt. Me fjalën tuaj ne u ndjemë pak jo të fyer se është fjalë e madhe por pak të ceduar sepse vendoset në diskutim besimin e Avokatit të Popullit dhe të Presidentit të Republikës. Duke qenë se kemi qenë këtu. Morali profesional edhe individual, qoftë i znj. Ballanca, i përfaqësuesve apo edhe i imi është që ne nuk e kemi dokumentuar sepse pajisjet e teknologjisë ta ofrojnë mundësinë që ta bësh edhe vetë.....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyr dhe i thotë mund ta bësh ?!

Bledar Dervishaj vijon dhe shprehet se por jo kurrë sepse ka një ligj, ka një rregull ka dhe moral mbi të cilën funksionojnë edhe individit edhe institucionet se individët e bëjnë. Të na thuash ne që ka mundësi se del, unë nuk e di. Por të na e thuash sot, na e kishe thënë janar shkurt dhe nuk vinim fare. Na kishe thënë në janar procesverbalin nuk e kam zbardhur dhe nuk ta jap....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyr dhe i thotë këtë nuk mund ta dija në atë kohe.

Bledar Dervishaj vijon dhe shprehet se kjo më ofendon sepse kam qenë në 100% të mbledhjeve. Ky qëndrim i juaji bie ne kurrizin tim, po na del jashtë kësaj mbledhje.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyr dhe shprehet: po patjetër. Unë nuk jam i ofenduar edhe me qëndrimet dhe thëniet tuaja, por nuk ka asnjë problem secili ka qëndrimet e veta.

Bledar Dervishaj vijon dhe shprehet se atëherë në qoftë se patjetër u bë mbledhja në datë 1 shkurt në datë 8 unë kisha mundësi të vija e të konsultoja 3 orë këtu. Ndërsa 3 orë herë 36 mbledhje, i bie 120 orë që duhet ti konsultoj tani për 10 ditë. Nuk e konsultoj dot këtë material dhe të vij këtu në Këshill. N.q.s do të ishte bërë step by step, mbledhje pas mbledhje,

mundësinë fizike kohore e kisha. Nuk e bej dot. Prandaj them mi jep ti administroj, do sekret e bëjmë sekret shtetëror, e vendosim....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se nuk e bej dot “sekret”.

Bledar Dervishaj vijon dhe shprehet se tashmë çfarë ngelet për të diskutuar në Këshill edhe konsumi i kohës nga Këshilli më duket i kotë sepse nuk ka të bëjë me një mendim ndryshe të Presidentit dhe një mendim ndryshe të Këshillit, por ka të bëjë me një mendim ndryshe të Presidentit dhe mendim ndryshe të kryetarit të Këshillit. Sepse Këshilli nuk ka marrë vendim të japë apo mos i japë. Nëse anëtarët e Këshillit e shtrojnë për diskutim, le ta ndryshojë këtë rregull dhe të thotë po, t’ia japë. Por kjo është vendosur. Atëherë na ngelet ne, si institucion që të gjykojmë me atë përgjegje që kemi marrë se çdo bëjmë. Do shprehemi ose do të themi që nuk i mbajmë dot mend. Meqenëse ju nuk na e plotësoni këtë kërkesë, vazhdoni në logjikën që e vlerësoni që është më e drejtë. Por do duhet ta mendojmë dhe ne në institucion. Por që fakti nuk është një gjë e mirë. Nuk e di për vitin tjetër që vjen, mungesa e burimeve etj., çfarë rëndësi ka, 3-4 orë ishin ato mbledhje, zbardhen, për mendimin tim gjithmonë. Tani janë trashure janë bërë aq shumë sa janë të pazgjdhshme.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se po të ishin kaq të thjeshta do të ishin bërë.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se ju z. kryetar jeni personi që përballeni drejtpërdrejtë me komunikimin për kopje të akteve, regjistrave. Formalisht që përballeni ju. Por për aq kohë që kjo çështje po merr shumë diskutim, unë them që të hidhet në diskutim në Këshill, që të mos të ngelet kështu sepse ju pjesën tuaj e keni bërë. Sepse ai ishte komunikimi, ju erdhi një shkresë zyrtare, normalisht në atë kohë që Këshilli nuk ishte i mbledhur, ju dolët me qëndrim dhe e keni mbajtur. Sepse ju jepni kopjet e akteve. Fakti që po na paraqitet për të njëzetën herë a mund të marrin kopje të regjistrimit audio tërësisht apo pjesërisht edhe n.q.s. nuk i marrim i ngelet tani përgjegjësia këtij Këshilli....

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se përgjegjësinë e kam unë, edhe penale madje. Nuk ka asnjë problem fare. Sepse është kompetenca dhe përgjegjësi e imja. Unë duhet ta siguroj dhe të garantoj të mos ndodhë gjë. Si do ta ushtrosh kompetencën dhe përgjegjësinë time?

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se ju mendoni që te mos merret një vendim këtë rast përderisa po pretendohet? Nëse mendoni kështu dhe anëtarët nuk mund të shprehen unë jam dakord. Por dua të dëgjoj zërin e anëtarëve sepse nuk po e dëgjoj. Zërin tuaj e dëgjoja.. N.q.s. anëtarët e tjerë mendojnë që kjo kompetence është e juaja unë

tërhiqem. Nuk e vë në dyshim komunikimin. Pjesa që po shtrohet i takon apo jo të marrë kopje të regjistrimit?

Anëtarët e Këshillit diskutojnë lidhur me propozimin e anëtares Margarita Buhali për të pasur vendimmarrje për dhënien e plotë a të pjesshme Avokatit të Popullit dhe të ftuarve të materialeve audio dhe transkripteve, të paktën për mbledhjet me natyrë të përgjithshme.

Anëtarët e Këshillit shprehën qëndrimin se mbledhjet janë të regjistruar në sistemin audio dhe ndërsa e mira ka qenë që në çdo mbledhje pasardhëse të miratonim procesverbalin e përmbledhur, duke pasur parasysh që ka pasur vështirësi të natyrave që u parashtruar gjatë kësaj mbledhjeje të mos marrin pjesë në një vendimmarrje të kësaj natyre, duke qenë se është një çështje e natyrës administrative.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe shprehet se më duhet të konsultohen me përgjigjen që ka ardhur, me Presidentin e republikës dhe tu kthej një përgjigje brenda ditës së nesërme lidhur me qëndrimin tonë. Pastaj Këshilli vazhdon siç do ta vlerësoni vetë. Tashti nuk ju them asnjë gjë. Nuk jam njohur me përgjigjen. Ju e morët sot dhe u përgjigjët po sot. Të njihemi me përgjigjen dhe tu kthejmë përgjigje mbi ato materiale që kam, pa marrë audio apo proces-verbal të plotë. Jepni kohë tu përgjigjemi. Kërkesën tonë e bëmë. Përgjigjen ju e thoni që e keni dërguar. Ta konsultoj dhe atë me kreun e shtetit dhe tju dërgojmë një koment apo shkrese mbi qëndrimin tonë me ato që na kanë ardhur. Për të qenë korrekt 19 + 9 bëjnë 28. Kemi kërkuar kopje të p-v të plota. Pasi u njohën me këtë kërkesë ne kemi bërë një kërkesë me shkrim ku kemi kërkuar që për 19 + 9 që kanë ardhur plus te gjitha që janë bërë, një kopje të proces-verbaleve të zbardhura 100% dhe një kopje të cd-ve, në mënyrë që të konsultohemi me to për të rifreskuar memorien tonë që nuk është aq-, që të kujtojmë mbledhjet e majit dhe prillit për të bërë miratimin. Përgjigja është dhënë sot nga kryetari, është administruar në institucionin tonë. Ti kthejmë një përgjigje sepse jam edhe përfaqësuesi, po jemi dakord me përmbajtjen, ose jo nuk mund ta kryej këtë funksion vijojmë sipas rregullit. Unë mendova se do bëhej një mbledhje Këshilli vetëm për këtë çështje, pra aty Këshilli do të miratonte të gjitha. Kështu e kam kuptuar unë. Në këtë mbledhje nuk e prisja miratim procesverbalesh. Këshilli do të mblidhet sepse kemi dhe raportin përmbledhës?

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe parashtron se duhet të ketë dhe një mbledhje të fundit. Sipas dakordësisë këtu po japim edhe pak kohë për procesverbalet. Formalisht duhet të kemi pasi do të vijmë edhe vakancat, besoj sot mbaron afati. Prapë kemi një detyrim formal që brenda 5 ditësh të mblidhemi. Si do procedojmë? Për kohën e

mbledhjes tjetër? Me sjelljen e kandidaturave, formalisht Këshilli do të mblidhet. Ta bëjmë në datë 30 dhjetor?

Anëtarët e Këshillit dakordësohen që mbledhja të jetë në datën 30 Dhjetor, ora do tju komunikohet.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani deklaroi të mbyllur mbledhjen

MBYLLET MBLEDHJA NË ORËN 15.55

Sekretare

Kryetar

Ermelinda Kadiu

Ardian Dvorani

Redjona Myrtja